

Shoqeria
Ares Konstruksion shpk
NIPT L 83717803T

SHENIME

MBI PASQYRAT FINANCIARE TE USHTRIMIT 2021

Pergatitja dhe paraqitja e Pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare te shoqerise (bilanci kontabel; pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve; pasqyra e fluksit te parase; pasqyra e ndryshimeve ne kapital) jane pergatitur ne perputhje me Ligjin Nr. 9228, date 29.4.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" (ndryshuar me Ligjin Nr. 9477, date 09.02.2006) dhe Standardet Kombetare te Kontabilitetit (shpallur me Urdherin e Ministrit te Financave Nr.4292, date 15.06.2006).

Pasqyrat financiare jane pergatitur mbi bazen e metodes te te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara (metoda e koston historike). Efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve te tjera jane njohur ne pasqyrat financiare kur ato kane ndodhur (dhe jo kur paraaja ose ekuivalentet e saj jane arketuar ose paguar) dhe jane regjistruar ne kontabilitet dhe raportuar ne pasqyrat financiare te periudhes kontabel te ciles i perkasin.

Pasqyrat financiare jane pergatitur mbi bazen e konceptit te materialitetit; informacioni i paraqitur eshte i plote per marrjen e vendimeve ekonomike te perdoruesve te pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne nje kontabilitet ushtrimor dhe ne vijueshmerine e veprimtarise se shoqerise.

Pasqyrat financiare mbulojne vetem veprimtarine e kesaj shoqerie raportuese dhe jane paraqitur ne leke.

Politikat kryesore kontabel

Elementet jane vleresuar ne llogari dhe jane paraqitur ne pasqyrat financiare me shumat qe percaktohen sipas standardeve kontabel dhe duke zbatuar te njejtat politika kontabel.

Aktivet financiare (mjetet monetare, kerkesat afatshkurtera dhe afatgjata per t'u arketuar, te ardhurat e konstatuara, investimet financiare, etj.) jane vleresuar fillimisht ne llogarite kontabel me kosto plus koston e transaksioneve per krijimin e tyre dhe jane paraqitur ne bilanc me koston e amortizuar.

Inventari eshte vleresuar fillimisht ne llogarite kontabel me kosto dhe eshte paraqitur ne bilanc me kosto te llogaritur sipas metodes hyrje e pare-dalje e pare.

Aktivet afatgjata materiale jane vleresuar fillimisht ne llogarite kontabel me kosto dhe jane paraqitur ne bilanc me kosto minus amortizimin e akumuluar.

Aktivet afatgjata jomateriale jane vleresuar fillimisht ne llogarite kontabel me kosto dhe jane paraqitur ne bilanc me kosto minus amortizimin e akumuluar.

Pasivet financiare (huate afatshkurtera e afatgjata, furnitoret, detyrimet ndaj punonjesve, detyrimet tatimore, parapagimet e arketuara, shpenzimet e konstatuara, etj.) jane vleresuar fillimisht ne llogarite kontabel me kosto plus koston e transaksioneve per krijimin e tyre dhe jane paraqitur ne bilanc me koston e amortizuar.



Provizionet janë vlerësuar me shumën me të saktë të mundshme të shpenzimeve të nevojshme për shlyerjen e detyrimeve që ekzistojnë në datën e bilancit.

Kapitali është paraqitur në bilanc me vlerën kontabel të kuotave të kapitalit, rezervave të kapitalit dhe fitimit të vitit financiar.

Të ardhurat janë vlerësuar në llogaritë kontabel dhe janë paraqitur në bilanc dhe në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me vlerën e drejtë të shumës së arketuar apo të arketueshme duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose të rabateve të ofruara.

Shpenzimet janë vlerësuar në llogaritë kontabel dhe janë paraqitur në bilanc dhe në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me vlerën e drejtë të shumës së paguar.

Transaksionet në monedhë të huaj janë vlerësuar fillimisht në lekë duke zbatuar mbi shumën e monedhës së huaj kursin e kembimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe pasivet monetare në monedhë të huaj janë paraqitur në bilanc të vlerësuar me kursin e kembimit në datën e bilancit. Aktivet dhe pasivet jomonetare në monedhë të huaj që maten me kosto historike janë paraqitur në bilanc të vlerësuar me kursin e kembimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe pasivet jomonetare në monedhë të huaj që maten me vlerën e drejtë janë vlerësuar me kursin e kembimit në datën kur është percaktuar vlera e drejtë.

Vlerësimet kontabel dhe ndryshimet e tyre

Gjatë vitit financiar Drejtimi i shoqërisë ka kryer vlerësimet kontabel për jetën e dobishme të aktiveve afatgjata dhe percaktimin e normave të amortizimit të tyre.

Në datën e bilancit u vlerësuan rrethanat apo treguesit që percaktojnë nevojat për kryerjen e testeve të zhvlerësimit të aktiveve afatgjata, inventareve dhe kërkesave të arketueshme; ndryshimet e provizioneve ekzistuese dhe krijimin e provizioneve të reja.

Ngjarjet pas dates së bilancit

Pas dates së bilancit deri në datën e depozitimit të tij nuk kanë ndodhur ngjarje që evidentojnë kushte që kanë ekzistuar në datën e bilancit, paraqitja e efektit të të cilave kërkon rregullime në Pasqyrat Financiare. Gjithashtu, nuk kanë ndodhur ngjarje që nuk evidentojnë kushte që kanë ekzistuar në datën e bilancit, paraqitja e efektit të të cilave nuk kërkon rregullime por përshkrimin perkates në shenimet shpjeguese.

BILANCI KONTABEL

Shënime të përgjithshme

Aktivët janë njohur në bilanc sepse: a) kontrollohen nga shoqëria; b) nga përdorimi i tyre priten të hyjnë në shoqëri përfitime të ardhshme ekonomike; c) kostoja e tyre mund të matet me besueshmeri.

Pasivet janë njohur në bilanc sepse: a) janë detyrime aktuale të shoqërisë; b) shlyerja e të cilave pritet të shoqërohet me daljen e burimeve në të ardhmen; c) shlyerja e të cilave mund të matet me besueshmeri.

Grandet janë njohur në bilanc sepse shoqëria ka siguri të mjaftueshme që: a) do të përmbushë kushtet për marrjen e tyre; b) grandet do të merren.

Provizionet janë njohur në bilanc sepse: a) shoqëria ka detyrime ligjore dhe konstruktive si rezultat i ngjarjeve të ndodhura para dates së bilancit; b) ekziston mundësia që për shlyerjen e detyrimeve të nevojiten dalje të burimeve; c) mund të behet një vlerësim relativisht i saktë i shumës së detyrimeve.

Kapitali i vet (aktivet neto) është njohur në bilanc si diferencë mes aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë në datën e mbylljes së ushtrimit.

Aktivët dhe pasivet nuk janë njohur në shumën neto në bilanc sepse shoqëria nuk ka të drejtë ligjore për t'i kompensuar ato.



** Shenimet vijuese (1-23) u referohen zerave te numertuar (1-23) ne kolonen "Shenime" te Bilancit kontabel.*

1. Mjetet monetare

Mjetet monetare ne daten e bilancit paraqiten ne shumen 12.101.750 leke dhe perbehen nga para ne banke ne shumen 12.090.086 leke dhe para ne arke ne Shumen 11.664 leke.

Hyrje-daljet e mjeteve monetare gjate ushtrimit paraqiten te detajuara ne "Pasqyra e fluksit te parase ne daten 31 Dhjetor 2021".

2. Derivative dhe Aktive financiare te mbajtura per tregtim

3. Aktive te tjera financiare afatshkurtera

Ne daten e bilancit aktivet e tjera financiare paraqiten me teprice per vleren e paarketuar te kerkesave te arketueshme ne shumen 93.900 leke vlere e cila perbehet nga kliente per shitje mallrash ne shumen 0 leke, tvsh kreditore ne vleren 93.856 leke, tatim-fitimi kreditore ne shumen 0 leke, furnitor debitor per parapagime per blerje malli dhe aktivesh ne shumen 0 leke. autoritetet doganore kreditore per shumen 44 leke.

4. Inventari

Menyra e ndjekjes kontabel te inventarit eshte inventari i ndermjetem.

Ne mbyllje te ushtrimit shoqeria nuk e ka kryer testin e zhvleresimit te inventarit pasi e gjykoi ate te panevojshem per kushtet e paraqitura.

Ne daten e bilancit inventari perbehet nga aktive te mbajtura per shitje(apartamente) ne shumen 98.359.048 leke.

5. Aktivet biologjike afatshkurtera

6. Aktivet afatshkurtera te mbajtura per shitje

7. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

8. Investime financiare afatgjata

9. Aktive Afatgjata Materiale

Ndryshimet e AAM-ve per ushtrimin jane paraqitur ne nje pasqyre qe shoqeron keto shenime.

Vlera e aktiveve ne mbyllje te ushtrimit paraqitet ne bilanc me vleren 807.154 leke

Ne mbyllje te ushtrimit aktivet paraqiten me zbritje ne vlere 201.789 leke zbritje kjo e shpenzimeve te amortizimit te AQT sipas normave tatimore ne fuqi

Amortizimi i AAM-ve eshte llogaritur sipas metodave te percaktuara ne SKK dhe ne Ligjin Nr. 8438, date 28.12.1998 "Per Tatimin mbi te Ardhurat".

Ndryshimet e amortizimit, metodat dhe normat e aplikuar per ushtrimin jane paraqitur ne pasqyrat qe shoqerojne keto shenime.

10. Aktivet biologjike afatgjata

11. Aktive Afatgjata Jomateriale

12. Kapitali aksionar i papaguar

13. Aktive te tjera afatgjata (ne proces)

14. Derivatet



15. Huamarrjet

16. Huate dhe parapagimet

Ne daten e bilancit huate dhe parapagimet paraqiten me teprice 112.529.231 leke e perbere per detyrime ndaj furnitoreve 33.832.859 leke, detyrime ndaj personelit per paga 638.875 leke detyrime tatimore 8.370 leke perbehet nga sigurime shoqerore i muajit Dhjetor 8.370 leke, TAP i muajit Dhjetor ne vleren 0 leke, tatim ne burim ne vleren 0 leke dhe tatim fitimi per tu paguar 0 leke, hua te tjera 9.800.741 leke, arketime ne avance per porosi 66.402.786 leke dhe huamarrje te tjera ne Shumen 1.845.600 leke

17. Grandet dhe te ardhurat e shtyra (afatshkurtera)

18. Provizionet afatshkurtera

19. Huate afatgjata

20. Huamarrje te tjera afatgjata

21. Provizionet afatgjata

22. Grandet dhe te ardhurat e shtyra (afatgjata)

23. Kapitali

Kapitali aksionar paraqitet ne bilanc ne shumen -1.167.379 leke dhe eshte kapitali (aksione) i aksionereve te shoqerise

Kapitali nenshkruar perbehet nga vlera 100.000 leke.

Rezervat ligjore perbehen nga shuma 0 leke si kusht ligjor per shoqerite me pergjegjesi te kufizuar.

Rezervat e tjera perbehen nga rezervat per investime ne shumen 0 leke.

Fitimi i pashperndare (humbje e mbartur) paraqitet ne bilanc ne shumen 340.815 leke vlere kjo e humbjeve te vitit te fundit.

Ne fund te ushtrimit kapitali eshte ulur ne krahasim me ushtrimin paraardhes ne shumen 926.564 leke, i ndikuar nga humbja e vitit financiar 926.564 leke.

Ndryshimet e ndodhura ne kapital gjate ushtrimit paraqiten te detajuara ne "Pasqyra e ndryshimeve ne kapital ne daten 31 Dhjetor 2021.

PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Shenime te pergjithshme

Te ardhurat jane njohur ne bilanc dhe ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve sepse: a) shoqeria ia ka kaluar bleresit rreziket dhe perfitimet qe lidhen me pronesine e mallrave; b) shoqeria nuk ka kontroll efektiv mbi mallrat e shitura; c) volumi i kryerjes se sherbimit ne daten e bilancit mund te matet me besueshmeri; d) shuma e te ardhurave mund te matet me besueshmeri; e) perfitimet ekonomike qe lidhen me transakcionet dhe sherbimet do te merren nga shoqeria; f) shpenzimet e kryera qe lidhen me transakcionet dhe sherbimet mund te maten me besueshmeri.

Te ardhurat dhe shpenzimet perfshijne si te ardhurat dhe shpenzimet e realizuara ashtu edhe ato te parealizuara.



Grandet janë përfshirë në të ardhurat e periudhës kontabel në përputhje me shumën e shpenzimeve që ato kanë kompensuar.

Shpenzimet janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sepse janë të lidhura me të ardhurat e realizuara gjatë të njëjtes periudhe kontabel.

Shpenzimet që nuk gjenerojnë të ardhura janë njohur si shpenzime në periudhën kontabel raportuese.

Shpenzimet që lidhen me të ardhura që do të realizohen në periudhat e ardhshme janë njohur në bilanc si aktive afatshkurtera.

Diferencat e kembimit që rezultojnë gjatë shlyerjes ose perkthimit të aktiveve dhe pasiveve në monedhë të huaj njihen si fitim (humbje) në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të periudhës kur ato linden.

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare janë njohur në shumën neto (kompensuar) pasi ato janë veprimtari dytesore për shoqëritë dhe paraqitja në këtë mënyrë jep një pamje me të kuptueshme të transaksioneve.

** Shenimet vijuese (1-7) u referohen zerave të numërtuar (1-7) në kolonën "Shenime" të Pasqyrës të të ardhurave dhe shpenzimeve.*

1. Të ardhurat nga veprimtaritë e shfrytëzimit

Të ardhurat nga keto veprimtari (shitjet neto, të ardhura të tjera, ndryshimet në inventarin e produktit të gatshëm, puna e kryer për qellimet e veta dhe të kapitalizuar) në mbyllje të ushtrimit u realizuan në shumën 0 leke e përbere nga të ardhura nga shitja e mallrave dhe interesa të fituara. Detajimi i tyre është bërë në pasqyrën që shoqëron keto shenime.

2. Shpenzimet nga veprimtaritë e shfrytëzimit

- Shpenzimet për lëndët e para përfaqësojnë koston e lendeve të para dhe materialeve të tjera të konsumuara gjatë veprimtarisë në shumën 0 leke.

- Shpenzimet për shërbimet përfaqësojnë koston e shërbimeve të kryera gjatë veprimtarisë në shumën 94.912 leke.

- Shpenzimet e tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit në shumën 0 leke janë të detajuara në pasqyrën që shoqëron keto shenime.

- Shpenzimet për pagat e punonjësve gjatë ushtrimit arrijnë shumën 485.454 leke dhe shpenzimet e sigurimeve shoqërore shumën 81.071 leke.

- Shpenzime të tjera 0 leke

- Amortizimi i Aktiveve Afatgjata është llogaritur sipas normave të vendosura nga shoqëria në shumën 201.789 leke.

Shpenzimet gjithsej nga veprimtaritë e shfrytëzimit në datën e bilancit paraqiten në shumën 863.226 leke.

3. Fitimi (Humbja) nga veprimtaritë e shfrytëzimit

Fitimi (Humbja) nga veprimtaritë e shfrytëzimit (diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve) u realizua në shumën (863.226) leke.

4. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare janë njohur në shumën neto (kompensuar) dhe rezultati në mbyllje të ushtrimit paraqitet, të ardhurat janë 5 leke dhe shpenzimet 63.343 leke dhe rezultati është fitim (humbje) në shumën (63.338) leke.

5. Fitimi (Humbja) para tatimit



Fitimi (Humbja) para tatimit ose rezultati kontabel perbehet nga fitimi (humbja) nga veprimtarite e shfrytezimit plus fitimin (humbjen) nga veprimtarite financiare dhe eshte percaktuar: fitim (humbje) ne shumen (926.564) leke

6. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Ne shpenzimet e ushtrimit jane renduar shpenzime ne vleren 0 leke te cilat, ne zbatim te Ligjit Nr. 8438, date 28.12.1998 "Per Tatimin mbi te Ardhurat" konsiderohen shpenzime te panjohura per efekt fiskal.

Shpenzimet e panjohura perbehen nga shpenzime per gjoba dhe penalitete ne shumen 0 leke.

Rezultati tatimor (rezultati kontabel plus shpenzimet e panjohura) eshte percaktuar: fitim(humbje) ne shumen (926.564) leke.

Rezultati tatimor i eshte nenshtruar tatimit mbi fitimin ne masen 0% % i cili rezulton ne vleren 0 leke .

7. Fitimi (Humbja) neto e vitit financiar

Fitimi (Humbja) neto e vitit financiar eshte (926.564) leke.

Fier me 10.03.2022

KONTABILISTI

Alfred Duro


ADMINISTRATORI

Nuri Duro

